

INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

Seria e kërkimeve politike
STUDIMI #1

MISIONI I KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË DHE PRIVATIZIMI I PRONËS SHOQËRORE

Përshkrim kritik i procesit aktual
të privatizimit në Kosovë

Prishtinë, qershor 2005
Ribotim

KIPRED

**MISIONI I KOMBEVE TË BASHKUARA
NË KOSOVË DHE PRIVATIZIMI I
PRONËS SHOQËRORE**

**Përshkrim kritik i procesit aktual
të privatizimit në Kosovë**

Prishtinë, qershor 2005
Ribotim

Këtë projekt e ka përkrahur Qendra Ndërkombëtare “Olof Palme”, Suedi dhe Rockefeller Brothers Fund, SHBA..

Mendimet e shprehura në këtë studim janë të autorit, pra nuk shprehin mendimet e KIPRED-it.

Ky hulumtim është përpiluar nga: Robert Muharremi

Ekipi redaktues:

Isa Blumi, redaktor i kërkimeve në KIPRED

Verena Knaus, hulumtuese ESI/LLA

Leon Malazogu, drejtor programi në KIPRED

Teuta Murati, bashkëpunëtore hulumtuese në KIPRED

Copyright © KIPRED 2005. Botimi i parë 2002. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sistem të rikthimit ose të transmetohet, në asnjë mënyrë dhe me asnjë mjet, në mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjim, incizim ose ndonjë mënyrë tjetër, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit. Ju lutemi, kontaktoni në postën elektronike: info@kipredinstitute.org ose në tel. +381 38 555 887.

I publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

“Kodra e Diellit”, Rruga 3, Lam. 39

Prishtinë, Kosova (UNMIK)

Telefoni&faksi: +381 38 555 887

www.kipredinstitute.org

Përmbajtja

Përmbledhje

I. Rrethanat politike, juridike dhe ato ekonomike

Sistemi politik dhe ai juridik
Situata ekonomike

II. Historia dhe koncepti i pronës shoqërore

III. Prona shoqërore nën administrim të UNMIK-ut

Administrimi i përbashkët UNMIK-komunë
Centralizimi dhe rivendosja e socializmit të këshillit të punëtorëve
Komericializimi
Privatizimi i pronave shoqërore nëpërmjet AKM-së
Rrethanat ligjore
Administrimi i ndërmarrjeve publike dhe atyre shoqërore
Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore
Udhëheqësia e AKM-së
Statusi ligjor i AKM-së
Mjetet juridike
Vërejtjet kritike

IV. Privatizimi i pronave të paluejtshme shoqërore

Histori
Veprimtaritë e tanishme legislative
Vërejtjet kritike

Përfundim

Rekomandimet e politikave

Transformimi i së drejtës për shfrytëzim në pronësi private
Ridefinimi i së drejtës për shfrytëzim
Aspektet procedurale
Aspektet qenësore
E drejta tregtare dhe civile në përgjithësi
Zbatimi me efektshmëri i ligjit

Shkurtesat

Shënime

Përmbledhje

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPV) janë themeluar para disa kohësh si institucione qeverisëse, të cilat përfaqësojnë popullin e Kosovës dhe veprojnë nën mandatin e Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Pavarësisht nga legjitimiteti i tyre demokratik, kompetencat e IPV-ve për ta shprehur vullnetin e popullit në proceset vendimmarrëse politike janë të kufizuara dhe i nënshtrohen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). PSSP-ja ka “pushtetin” kyç për çështjet kryesore, siç janë punët e jashtme, drejtësia, rendi publik dhe zhvillimet makroekonomike.

Megjithatë, IPV-të, si përfaqësuese legjitime të popullit të Kosovës, kanë të drejtën dhe përgjegjësinë për shqyrtime, vlerësime, analiza dhe kritika lidhur me vendimet politike të PSSP-së, edhe nëse çështjet në fjalë janë nën kompetencë të tij. Kapaciteti për ta mbikëqyrë me efektshmëri veprimtarinë politike të PSSP-së kërkon, pikë së pari, një nivel të lartë të informacioneshve dhe një vullnet politik për ta bërë këtë. Ky dokument synon arritjen e synimit të parë nga këta të dy.

Situata e tanishme ekonomike, jo aq shpresëdhënëse, duhet të shpëputet nga mbeturinat e quajtura “prona dhe ndërmarrje shoqërore”, nëse mëton të zhvillohet në një ekonomi të tregut të lirë të efektshme dhe të vetëqëndrueshme. Prandaj, sikur edhe në vendet e tjera paskomuniste, fjala kyçe edhe këtu është “privatizimi”. Meqë tashmë ekziston një përvojë lidhur me privatizimin, nuk kemi nevojë “ta rizbulojmë Amerikën”. Por, në fakt, ky privatizim duhet t’u përshtatet kushteve të Kosovës, duke marrë parasysh faktorët e veçantë politikë, historikë, ekonomikë dhe shoqërorë, dhe sidomos çështjen e hapur të statusit përfundimtar politik të Kosovës. Megjithatë, vështirësitë me të kuptuarit e natyrës ligjore të pronës shoqërore u kanë lënë shumë vend spekulimeve teorike lidhur me atë se kush është zotëuesi i njëmendtë i pronave shoqërore. Kjo gjë, në fund, nuk e ndihmon zgjidhjen e problemit. Prandaj, prona shoqërore mbetet ende një mister për zyrtarët ndërkombëtarë të përfshirë në këtë çështje.

Pas ushtrimit të autoritetit mbi ndërmarrjet shoqërore (NSH) nga autoritetet komunale, në bashkëpunim me zyrtarë të UNMIK-ut, komunat përherë e më shumë filluan të mënjanohej nga funksioni fillestar mbikëqyrës që kishin. Paaftësia e Departamentit të Tregtisë dhe Industrisë (DTI) për ta ushtruar me efektshmëri kontrollin dhe menaxhimin mbi ndërmarrjet shoqërore, rezultoi me një vakuum ligjor. Ky vakuum ligjor u keqpërdor nga ndërmarrjet shoqërore, të cilat filluan, – megjithëse pa qartësimet e duhura ligjore - t’i japin pronat me qira. Tentimet e para për rigjallërimin e ekonomisë së Kosovës nëpërmjet komercializimit, duke synuar ta tërhiqnin kapitalin vendor dhe atë të huaj, dështuan. Aktualisht, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) është organi i ngarkuar për t’i administruar ndërmarrjet publike dhe shoqërore. Mandati i AKM-së

përfshin, po ashtu, edhe privatizimin e pronës shoqërore, nëpërmjet të së ashtuquajturës “procedurë e amputimit” (spin-off). Në anën tjetër, mandati (aktual) i AKM-së nuk lejon privatizimin e pronave të paluejtshme shoqërore (trojet dhe objektet), të cilat janë të vetmet prona të vlefshme të këtyre ndërmarrjeve dhe të cilat aktualisht nuk po përdoren për prodhim industrial, por vetëm për qëllime të dhënies me qira. Pa privatizimin e këtyre pronave, kurrfarë privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore nuk do të ishte frytdhënës.

Privatizimi i pronave të paluejtshme shoqërore është një akt shumë më i komplikuar sesa privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore. Interesat komerciale dhe ekonomike janë të vetmet aspekte që duhet të merren parasysh. Aspektet e tjera të rëndësishme, që duhet të shqyrtohen, janë kthimi i pronarëve të shpronësuar më parë, interesat e komunës dhe ato të administratës lokale. Çdo përpjekje serioze për privatizimin e pronës së paluejtshme shoqërore duhet të koordinohet me të tri aspektet e lartpërmendura. Modeli i propozuar në këtë dokument është ai gjerman “Treuhand”, i cili ishte autorizuar që ta privatizonte të ashtuquajturën “Volkseigentum” (pronë e popullit), e cila – si koncept – është shumë e ngjashme, nëse jo edhe identike, me pronën shoqërore në Kosovë. Megjithatë, dokumenti që keni në dorë mund të shërbejë si bazë për mendime dhe shqyrtime të mëtejme në këtë drejtim dhe zgjidhjet e paraqitura në të nuk duhet të trajtohen doemos si të vetmet zgjidhje.

I. Rrethanat politike, juridike dhe ato ekonomike

Analizat e procesit aktual të privatizimit mund të kuptohen vetëm përbrenda kontekstit të situatës politike dhe ekonomike të Kosovës. Meqë Kosova është nën administrim të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara, gjendja këtu nuk është “normale”, krahasuar me cilindo nga vendet ish-socialiste fqinje, të cilat ishin ose janë në procesin e transformimit prej sistemit socialist në atë demokratik me ekonomi të tregut të lirë.

1. Sistemi politik dhe ai juridik

Me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS i OKB-së), të datës 10 qershor, që vepron nëpërmjet Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara (UNMIK), është marrë e gjithë përgjegjësia administrative mbi Kosovën. Kompetencat e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), i cili është autoriteti më i lartë në Kosovë, janë mjaft të mëdha dhe përfshijnë gjithë pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv, duke përfshirë edhe administrimin e drejtësisë.

Për t'i përmbushur detyrat që i besohen Administratës së Përkohshme nga Rezoluta 1244 (1999) e KS të OKB-së, PSSP-ja ka të drejtë të nxjerrë dekrete legjislative në formë të rregulloreve dhe instrumenteve ndihmëse (udhëzimeve administrative)¹. Legjislacioni i zbatueshëm në Kosovë përfshin të tilla dekrete ligjore të nxjerra nga PSSP-ja, si dhe ligjet e brendshme që ishin në fuqi para datës 22 mars 1989, pra një ditë para suspendimit të autonomisë së Kosovës nga Serbia². Ligjet e brendshme përbëhen nga legjislacioni federal, republikan dhe ai krahinor. Ligjet, të cilat kanë hyrë në fuqi pas datës 22 mars 1989, mund të zbatohen vetëm nëse lënda e çështjes ose situata e caktuar nuk është e mbuluar nga ligjet në fuqi para datës 22 mars 1989 dhe nëse legjislacioni i tillë nuk është diskriminues apo në kundërshtim me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht³.

Në rast të konfliktit mes dekreteve ligjore të UNMIK-ut dhe ligjeve të zbatueshme të brendshme, ligjet që do të mbizotërojnë janë dekretet ligjore të UNMIK-ut⁴.

Sa i përket organizimit administrativ të Administratës së Përkohshme, UNMIK-u kryesohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, si autoriteti më i lartë civil në Kosovë, i cili ka katër zëvendës-PSSP. Çdo zëvendës i PSSP-së i përgjigjet PSSP-së, dhe njëherit është kryetar i së ashtuquajturës “shtyllë”, e cila ngarkohet me kryerjen e funksioneve të caktuara administrative. Kjo “shtyllë” drejtohet nga një organizatë e caktuar ndërkombëtare. Katër shtyllat e tanishme përfshijnë policinë dhe drejtësinë (OKB), Administratën Civile (OKB), demokratizimin dhe aftësimin e kuadrave (OSBE), si dhe rindërtimin ekonomik (BE).

Me ardhjen e Administratës së Përkohshme, në qershor të vitit 1999, sfida e parë e

UNMIK-ut ishte të vendosej si pushtet i vetëm në Kosovë dhe të përballej me strukturat paralele të Republikës së Kosovës, me Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, si dhe me strukturat paralele të Serbisë, në vendet ku popullata serbe përbënte shumicën. Në fillim të vitit 2000, UNMIK-u ia doli t'i integronte strukturat paralele në Strukturat e Përbashkëta të Administratës së Përkohshme (SPAP). SPAP-i përbëhej nga grupet e përziera këshillimore ndërkombëtare/vendore dhe nga departamentet administrative, të kryesuar nga bashkëkryesuesit ndërkombëtarë dhe ata vendorë. Megjithatë, SPAP-i vepronte nën autoritetin e plotë të PSSP-së.

Me miratimin e Kornizës Kushtetuese, të datës 15 maj 2001, u krijuan Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPV). Këto institucione përfshijnë strukturat qeveritare, siç janë Kuvendi i Kosovës, i zgjedhur nga populli i Kosovës, Qeveria dhe Zyra e presidentit të Kosovës, ndërsa departamentet e mëparshme të SPAP-it u shndërruan në ministri. Pavarësisht nga krijimi i institucioneve vetëqeverisëse dhe kalimi i përgjegjësisë të caktuara por të kufizuara, PSSP-ja ende mbetet autoriteti suprem në Kosovë. Ligjet, megjithëse të përgatitura dhe të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, mund të hyjnë në fuqi vetëm nëse miratohen nga PSSP-ja. Të njëjtat parime vlejné edhe për marrëveshjet ndërkombëtare. Kompetencat e rezervuara për PSSP-në përfshijnë shpërndarjen e Kuvendit në rast të një shkeljeje serioze të Rezolutës 1244 (1999) të KS të OKB-së, mbrojtjen e minoriteteve dhe shumë çështje të tjera pushtetare, si: politika monetare, mbrojtja, rendi publik, etj. Pas vështirësive fillestare për gjetjen e një kompromisi të përshtatshëm rreth përbërjes së Qeverisë dhe të Zyrës së kryetarit të Kosovës, tani përpjekjet politike dhe juridike ndërmjet UNMIK-ut dhe IPV-ve përqendrohen rreth definimit të qartë të atyre përgjegjësisë që u janë bartur Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, si dhe të atyre kompetencave të rezervuara, të cilat ende i ka UNMIK-u. Megjithëse është rënë dakord sa u përket parimeve themelore në kontekstin e legjislacionit ekonomik dhe fiskal, si dhe brenda mekanizmave të themeluar në kuadër të Këshillit Ekonomik Fiskal, situata ligjore ende është e paqartë sa i përket iniciativës ligjvënëse dhe bashkëpunimit ndërmjet IPV-ve dhe UNMIK-ut.

Situata ekonomike

Ekonomia e Kosovës para vitit 1999 është karakterizuar me ekonominë socialiste dhe centraliste të Jugosllavisë, ku prona dhe ndërmarrjet shoqërore kanë qenë gjeneratorë të ekonomisë së vendit. Megjithatë, ky lloj ekonomie çoi në administrim të keq dhe shpërndarje të dobët të mjeteve, prandaj rezultoi me një ekonomi të dobët. Përveç kësaj, kriza politike që nga viti 1989 e përkeqësoi edhe më tej situatën ekonomike. Shumica e popullatës shqiptare të Kosovës u largua nga shërbimet publike dhe ekonomike dhe mundësitë për arsimim të mirë ishin të kufizuara. Krahas ekonomisë shtetërore, popullata shqiptare u fut në veprimtari të fshehta ekonomike, kryesisht me treg të zi dhe ndërmarrje të vogla, ku të punësuarit ishin kryesisht familjarë. Në anën tjetër, krahas konflikteve që zhvilloheshin, ndërmarrjet dhe pronat shtetërore dhe shoqërore u braktisën dhe u shkatërruan, gjë që rezultoi me përkeqësim të mëtejshëm.

Me vendosjen e pranisë ndërkombëtare, u bë e qartë se ekonomisë së Kosovës i nevojiteshin ndryshime rrënjësore strukturore, në mënyrë që ajo të zhvillohet në një ekonomi të tregut të lirë. Tani, në sipërfaqe, Kosova është një vorbull e veprimtarive ekonomike, porse mbetet kryesisht shoqëri konsumuese, kërkesat e së cilës po plotësohen falë bujarisë së donatorëve ndërkombëtarë dhe të diasporës kosovare⁶. Në fakt, bruto prodhimi vendor (GDP) i Kosovës, ta zëmë, është shtuar për rreth 13% në vitin 2001 dhe pritet të shtohet edhe për 7-8% gjatë vitit 2002. Megjithatë, kjo ngritje nuk është rezultat i veprimtarisë tregtare vendore, por rezultat i ndihmave nga jashtë dhe i të hyrave nga diaspora e Kosovës⁷.

Prandaj, ekonomia e vendit mund të përshkruhet si ekonomi importi. Importi është shtuar nga 1.963 milionë euro në vitin 2000, në 2.097 milionë euro në vitin 2001. Për vitin 2002 importi pritet të kapë shumën prej 2.277 milionë eurosh. Sa i përket mallrave të importuara, mbizotërojnë mallrat e përpunuara (p.sh. ushqimi dhe benzina) kundrejt lëndëve të para dhe pajisjeve. Në anën tjetër, eksporti mbetet në një nivel shumë të ulët (107 milionë € në vitin 2000, 181 milionë € në vitin 2001, 201 milionë € të parashikuara për vitin 2002). Për pasojë të kësaj kemi deficit të madh tregtar me mbizotërim të importit ndaj eksportit.

Deficiti tregtar balancohet nëpërmjet ndihmave të donatorëve ndërkombëtarë, si dhe të të hyrave që dërgohen nga diaspora. Që nga viti 1999, donatorët ndërkombëtarë kanë kontribuar me 2.1 miliardë euro, prej të cilave 1,5 miliard euro tashmë janë shpenzuar për rindërtim. Të hyrat e dërguara nga diaspora vlerësohet se kapin një shumë 500 milionë euro në vit. Megjithatë, donatorët kryesorë ndërkombëtarë, kohët e fundit, kanë paralajmëruar zvogëlim të ndihmës financiare për Kosovën⁸.

Ekonomia ekzistuese e vendit nuk do të mund ta plotësonte boshllëkun e krijuar me largimin e ndihmës ndërkombëtare dhe, kështu, deficit i lartpërmendur tregtar do të kthehej në një problem serioz. Shkaku i kësaj është zhvillimi i pamjaftueshëm i sektorit privat në Kosovë. Kompanitë private janë kryesisht të përfshira në tregti me shumicë/pakicë, shërbime ndërtimore dhe hoteliere dhe, pothuajse, asnjë në industri dhe në bujqësi⁹. Po ashtu, pothuajse nuk ekzistojnë as prodhimi industrial dhe ai bujqësor. Investimet në këta sektorë vështirësohen për kompanitë private, për shkak të infrastrukturës së pazhvilluar financiare. Sistemi bankar, i krijuar kohëve të fundit, po përballlet me mungesë të një kornize mbi të drejtat pronësore, bankrotimin dhe sistemin e dobët gjyqësor, të gjitha këto elemente që e shtojnë rrezikun e kredituesit. Kjo pasohet nga një normë e lartë interesi (mes 12,5 dhe 25%) me afat të shkurtër (maksimumi deri në dy vjet), prandaj investimet private në sektorin e industrisë dhe të bujqësisë nuk janë joshëse.

Në anën tjetër, ndërmarrjet shoqërore, që në sistemin socialist ishin shtyllë kryesore e zhvillimit dhe prodhimit industrial dhe atij bujqësor, sot mezi që kryejnë ndonjë veprimtari industriale ose bujqësore. Veprimtaria kryesore e ndërmarrjeve shoqërore

është dhënia me qira e mjeteve personave privatë dhe atë, kryesisht, dhënia e trojeve dhe e objekteve.

Kjo situatë e shpjegon deficitin e madh tregtar me mbizotërim të importit mbi eksportin: thjesht, nuk ekziston prodhim industrial dhe bujqësor që vlen të përmendet. Shumë analistë këtë situatë e përshkruajnë si proces të deindustrializimit të Kosovës¹⁰. Në kontekstin e riformësimit të ekonomisë së Kosovës me qëllim të forcimit të saj, në mënyrë që ajo të bëhet ekonomi e pavarur, e prirë nga investimet private vendore dhe të jashtme, si çështje kyçe na paraqitet privatizimi i pronave shoqërore.

II . Historia dhe koncepti i pronësisë shoqërore

Marrëdhëniet e pronave të patundshme përcaktojnë kushtet dhe kufijtë e shfrytëzimit dhe të përdorimit kryesisht të trojeve dhe objekteve si mjete vitale të çdo shoqërie. Përmbajtja e këtyre marrëdhënieve ndryshon nga një sistem ligjor-politik te tjetri. Pronat shoqërore, meqë janë ende të pranishme në Kosovë, janë relikte të sistemit socialist jugosllav dhe dallojnë nga koncepti i marrëdhënieve pronësore në Evropën Perëndimore.

Sistemi klasik evropërendimor i pronave të patundshme njeh pronën private dhe atë shtetërore/publike, si dy kategoritë kryesore të pronave. Personat privatë kanë të drejtë shfrytëzimi, tjetërsimi dhe ngarkimi të pronave të patundshme. Kufizimet e këtij *ius utendi et abutendi* re janë të mundshme vetëm po qe se vijnë nga ligjet dhe janë në shërbim të interesit të përgjithshëm publik. Pronat shtetërore/publike mbahen nga autoritetet publike (organet shtetërore, komunale, agjencitë/institucionet publike dhe ndërmarjet publike) dhe shërbejnë për interesa publike.

Prona shoqërore është një kategori në vete dhe nuk mund të përlidhet nga termat dhe nocionet tradicionale të Evropës Perëndimore mbi pronën private dhe atë shtetërore/publike. Socializmi është një reagim ideologjik kundrejt kapitalizmit, i cili është themeluar mbi nocionin e ekonomisë së tregut të lirë, që për gjenerator të progresit dhe pasurisë ekonomike ka pronën private. Duke e marrë parasysh pozitën e kushteve të vështira të fuqisë punëtore gjatë shekujve XVIII dhe XIX, socializmi e shpalli ideologjinë e shoqërisë pa klasa, në të cilën punëtorët nuk shfrytëzohen nga ata që privatisht i posedojnë mjetet e prodhimit, (p.sh. tokat, objektet, makinat). Qëllimi i tij ishte që të krijohet një shoqëri, në të cilën të gjithë pjesëtarët e saj do të mund t'i shfrytëzonin mjetet e disponueshme të prodhimit me qëllim të përmbushjes së nevojave personale, si dhe nevojave të shoqërisë. Si rrjedhim, hapi i parë i socializmit ishte zhdukja e kategorisë së pronës private, e cila konsiderohej si thelbi i së ligës dhe shkaku kryesor për shfrytëzim të pamëshirshëm të fuqisë punëtore dhe të ndarjes së shoqërisë në klasën e të pasurve dhe në atë të të varfërve¹¹.

Në Jugosllavi, procesi i shndërrimit të pronës private në pronë shoqërore filloi me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, atëherë kur forcat socialiste, nën udhëheqjen e Titos, u bënë forcat më të forta politike në vend. Megjithatë, ky proces kaloi përmes fazës së nacionalizimit, pra të transformimit fillimisht në pronë shtetërore, para se të transformohej në pronë shoqërore. Që nga viti 1945, u nacionalizua prona private e “armiqve” dhe e “kolaboracionistëve”, e cila u përkiste kryesisht grupeve liberale dhe antikomuniste¹². Veç kësaj, tokat bujqësore me pronësi private ishin të kufizuara dhe ato që e kalonin kufizimin e caktuar, gjithnjë nacionalizoheshin¹³. Kushtetuta e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë, po ashtu, parashihte se të gjitha mjetet natyrore ishin pronë shtetërore. Periudha pas vitit 1945 njihet si periudhë e administrimit qendror ekonomik, meqenëse ndërmarrjet ishin të detyruara të funksiononin nën kontrollin shtetëror. Shteti ushtronte kontroll kryesisht nëpërmjet planeve operative, si dhe duke caktuar objektiva ekonomike që duhej të arriheshin nga ndërmarrjet shtetërore.

Ekonomia e kontrolluar nga shteti që për mjete kyçe kishte pronën shtetërore, nuk ishte qëllimi ideal dhe i fundit i Jugosllavisë socialiste. Ideologjikisht, qëllimi i fundit i socializmit ishte zhvillimi i një shoqërie të udhëhequr nga punëtorët, e cila në fund do të rezultonte me zhdukjen e shtetit si të tillë. Prandaj, nacionalizimi dhe ekonomia nën kontroll shtetëror kundroheshin vetëm si fazë kalimtare deri në arritjen e qëllimeve të fundit të vetëqeverisjes së plotë nga ana e punëtorëve. Faza e dytë, e cila shënon fillimin e procesit drejt vetëqeverisjes nga punëtorët, fillon nga fundi i viteve të 50-ta. Nëpërmjet një varg legjislacioneesh, ndërmarrjet ishin liruar nga administrimi i drejtpërdrejtë shtetëror dhe ishin vendosur këshillat e punëtorëve që t'i menaxhonin ndërmarrjet.

Në të njëjtën kohë filloi edhe tjetërsimi i pronës shtetërore në pronë shoqërore. Kulmi i këtij procesi arrihet me Kushtetutën Federative të vitit 1974, e cila parashihte që të gjitha mjetet e prodhimit dhe mjetet e tjera të punës kolektive, produkti dhe të hyrat e fituara nëpërmjet punës kolektive, mjetet e duhura për plotësimin e nevojave publike, rezervat natyrore dhe mjetet e tjera të caktuara për shfrytëzim publik, të ishin pronë shoqërore. Kjo i përfshinte, por pa u kufizuar me to, trojet për ndërtim, tokat bujqësore të shfrytëzuara nga ndërmarrjet shoqërore, ndërtesat dhe apartamentet e ndërtuara me fitimet e krijuara nga shfrytëzimi i pronave shoqërore.

Prona shoqërore, si e tillë, është menduar të jetë një kategori juridike në vetë, e ndryshme nga prona private dhe ajo shtetërore. Tipar kryesor i saj ishte që askush të mos kishte të drejtën të fitonte kurrfarë pronësie ndaj mjeteve që cilësoheshin si pronë shoqërore. Pronari suprem i emëruar i pronës shoqërore ishte vetë shoqëria. Personave fizikë u lejohej vetëm që ta gëzonin shfrytëzimin e pronës shoqërore.

Meqë shoqëria është një genie aq abstrakte, duhej të kishte një organ që të vepronte si agjent i shoqërisë, me qëllim të administrimit të pronave shoqërore. Ta zëmë, nëse ndonjë individ dëshironte ta fitonte të drejtën për përdorimin e trojeve për ndërtim, organi përkatës me zotësinë ligjore, do të vendoste për këtë në emër të shoqërisë. Një

raport i përgatitur nga profesori gjerman Stephan Hobe, identifikonte tri organe potenciale, me fjalë të tjera shtetin – prandaj ishte e vështirë të kuptohej nëse kjo ishte Federata e Jugosllavisë, Republika e Serbisë, apo Krahuina e Kosovës - komunat apo vetë këshillat e punëtorëve¹⁴. Fatkeqësisht, rezultati i analizave ishte se të tri organet mund të konsiderohen si agjentë të shoqërisë dhe për këtë shkak situata juridike bëhet shumë e paqartë.

Duke pasur parasysh këtë situatë, shumica e argumenteve janë në favor të komunave për t'i kualifikuar ato si agjentë të shoqërisë, sa i përket autoritetit rreth administrimit të pronës shoqërore *për* dhe *në emër* të shoqërisë. Komunat ishin ato entitete të cilat kishin të drejtën për ta hequr të drejtën për shfrytëzim, duke ua bartur këto të drejta personave fizikë ose ndërmarrjeve shoqërore (p.sh. në rastin e tokave bujqësore ose të trojeve ndërtimore)¹⁵. Komunat, po ashtu, ishin të caktuara për të bërë tjetërsimin (për vetëm disa raste që përshkruheshin me ligj) të pronave shoqërore në prona private (të lejuara për ndërtesa dhe apartamente, por të ndaluara rreptësisht për troje ndërtimi)¹⁶. Kur komuna e jepte të drejtën për shfrytëzim, ishte po ashtu komuna ajo që do të ushtronte kontroll mbi atë se *si* dhe *për çfarë qëllimi* po shfrytëzohej prona shoqërore. Obligimet mbroheshin ose me ligje relevante ose me anë të kontratës konkrete, nëpërmjet të cilës komuna e jepte të drejtën për shfrytëzim. Pra, p.sh. në rastet e ndërmarrjeve shoqërore, komuna duhej të ndërhynte, nëse një ndërmarrje shoqërore nuk e shfrytëzonte pronën shoqërore në mënyrë të duhur, ose kur ajo nuk i mirëmbante dhe nuk i shtonte vlerat e pronës shoqërore, ose kur ndërmarrja shoqërore e shfrytëzonte pronën shoqërore në kundërshtim me ligjin ose me kontratën e lidhur. Në këto raste, komuna kishte autoritetin që ta shkarkonte bordin ekzekutiv, ta shpërndante këshillin e punëtorëve, të caktonte një udhëheqësi të re të përkohshme dhe të kufizonte të drejtën e vetëqeverisjes së punëtorëve¹⁷. Po ashtu, duhet të theksojmë se, në rast të likudimit të ndërmarrjes shoqërore, toka dhe objektet që i takonin ndërmarrjes shoqërore i ktheheshin komunës vetëm atëherë pasi të gjithë kreditorët të ishin deklaruar se ishin ndarë të kënaqur¹⁸.

Këto kompetenca dhe përgjegjësi të komunës janë argumente të fuqishme për të konkluduar se komunat vepronin për dhe në emër të shoqërisë, sa i përket çështjes së administrimit të pronës shoqërore. Po ashtu, duhet të theksojmë se, sipas teorisë socialiste, e cila parashihte shoqërinë pa klasa ose pa shtet, ku punëtorët do të vetëqeverisnin, shteti nuk do të ketë mundur të kishte autoritet mbi administrimin e pronave shoqërore, përveç nëse sistemi socialist do të synonte ta kundërshtonte vetveten. Shteti do të duhej të shuhej dhe, prandaj, atij nuk i ishte besuar administrimi i mjeteve themelore të shoqërisë socialiste, ose me fjalë të tjera, të pronës shoqërore.

Sistemi i përshkruar më sipër ishte në fuqi në vitin 1989 në Kosovë dhe ky sistem pasqyron ligjin e zbatueshëm sipas përkufizimit të UNMIK-ut, kur ky i fundit hyri në Kosovë në vitin 1999. Megjithatë, gjatë periudhës prej dhjetë vjetësh, që nga viti 1989 e deri në vitin 1999, i tërë sistemi administrativ dhe ai politik, nëpërmjet të të cilëve

funksiononte institucioni i pronës shoqërore, gradualisht po degradohej dhe pas vitit 1999 ai nuk ekzistonte fare. UNMIK-u, po ashtu, mbështeste rrugën e zhvillimit të një ekonomie të tregut të lirë dhe nuk dëshironte të rivendoste ekonominë e sistemit socialist, e cila ishte parakusht për funksionimin e sistemit socialist të pronës. Si pasojë, krahas me shpërfaqjen e një sistemi demokratik dhe me ekonomi të tregut të lirë, e vetmja mbeturinë problematike e një sistemi socialist joekzistues mbetën pronat dhe ndërmarrjet shoqërore.

III. Prona shoqërore nën administrimin e UNMIK-ut

Kur UNMIK-u hyri në Kosovë, detyra e parë e tij ishte të vendosej si pushtet i vetëm legjitim i Kosovës. Çështjet e para me të cilat u mor UNMIK-u ishin Ligji Penal dhe Rendi Publik. Gradualisht UNMIK-u u detyrua të merret me çështjet civile dhe tregtare, e sidomos me pronat shoqërore. Pjesa e mëposhtme synon t'i përvijojë zhvillimet që nga dita e vendosjes së UNMIK-ut deri më sot, sa i përket administrimit të pronës shoqërore, si dhe qasjet e ndryshme për ringjallërimin e ekonomisë së Kosovës.

Administrimi i përbashkët UNMIK–komunë

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.1999/1, UNMIK-u ka pushtet të plotë për administrim të pronës shtetërore, publike dhe asaj shoqërore. Pavarësisht nga pushteti ligjor që ka UNMIK-u, ai shumë pak e ka zbatuar atë në praktikë.

Kur UNMIK-u mori mandatin për administrimin e Kosovës, në qershor të vitit 1999, ai u përball me një situatë të ngatërruar politike. Pushteti serb ishte larguar, strukturat e Republikës së Kosovës, sado që ekzistonin, ishin të paefektshme dhe vakuumi i krijuar politik do të mbushej me strukturat e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës. Hapi i parë i UNMIK-ut ishte vendosja si pushtet më i lartë në Kosovë dhe, në janar të vitit 2000, arriti t'i integronte të dy strukturat në Strukturat e Bashkuara të Administratës së Përkohshme. Gjatë kësaj kohe, ndërmarrjet dhe pronat shoqërore ishin *de facto* nën kontrollin politik partiak, dhe jo nën administrim të UNMIK-ut.

Situata filloi të ndryshojë në vitin 2000, kur drejtuesit komunalë të UNMIK-ut, së bashku me këshillat komunale, tentuan ta rivendosnin mekanizmin e kontrollit të para vitit 1989, i cili në të njëjtën kohë ishte në pajtim me legjislacionin në zbatim. Ndërmarrjet shoqërore ishin të detyruara të paraqitnin raporte të rregullta financiare, të cilat i nënshtroheshin komunës për miratim. Komuna, po ashtu, mori të drejtën të ushtronte të drejtat e lartpërmendura në rastin e kundërvajtjeve ligjore nga ndërmarrjet shoqërore¹⁹. Megjithatë rezultati i kontrollit komunal mbi ndërmarrjet dhe pronat shoqërore ishte mjaft i dobët, është mëse e nevojshme të theksohet se komunat, të pakta, bënë përpjekje për ta rikthyer pushtetin e tyre mbi ndërmarrjet dhe pronat shoqërore.

Centralizimi dhe rivendosja e socializmit të këshillit të punëtorëve

Në mënyrë mjaft paradoksale, periudha e mbikëqyrjes komunale mbi ndërmarrjet shoqërore përfundoi me zgjedhjet e para komunale në dhjetor të vitit 2000²⁰. Nën udhëheqjen administrative të Departamentit të Tregtisë dhe Industrisë, i cili u formua në dhjetor të vitit 2000, UNMIK-u ndërroi politikën e tij ndaj administrimit të pronave shoqërore dhe, në veçanti, politikën e administrimit të ndërmarrjeve shoqërore. Qasja e re ishte eliminimi i tërësishëm i komunave nga procesi i kontrollit dhe, kështu, centralizimin e këtij procesi nëpërmjet DTI-së në nivel autoritar qendror. Megjithatë, problemi kryesor ishte se DTI-ja nuk kishte kuadra të mjaftueshme administrative dhe nuk kishte as përvojë as dijeni të mjaftueshme juridike për ta ushtruar këtë funksion.

Duke u përballur me këto vështirësi, DTI-ja ndërmoi një hap për ta rivendosur këshillin e punëtorëve, si një instrument për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në ndërmarrjet shoqërore. Këshillat e punëtorëve duhej t'i kryenin detyrat e veta, siç kishin bërë në periudhën para vitit 1989. Por, në vitin 2000, situata politike-shoqërore ishte krejt ndryshe. UNMIK-u donte të zhvillonte një shoqëri demokratike me ekonomi të tregut të lirë. Partia komuniste tashmë nuk ekzistonte në Kosovë, por ishte zëvendësuar me sistem partiak pluralist. Këshillat e punëtorëve ishin krijuar për të funksionuar në sistemet ekonomike socialiste dhe centraliste dhe, prandaj, nuk përputheshin me situatën e tanishme politike dhe ekonomike në Kosovë. Të gjitha elementet e sistemit, të cilat e bënin këshillin e punëtorëve funksional dhe të efektshëm, siç ishin kontrolli i efektshëm komunal dhe kontrolli politik nëpërmjet partisë komuniste, qenë zhdukur. Nën këto rrethana, rivendosja e këshillave të punëtorëve dhe eliminimi i komunave nga procesi i kontrollit nuk ishin vetëm anakronizma të pazakontë, por edhe dy gabime të mëdha politike, meqë ato ua mundësonin ndërmarrjeve shoqërore të funksiononin pa iu nënshtruar *de facto* çfarëdo kontrolli administrativ ose juridik.

Në fund, kjo situatë rezultoi me dhënien e mjeteve dhe të ndërmarrjeve shoqërore me qira, gjë që, në fakt, ishte shkelje e ligjeve të zbatueshme në kundërshtim të procesit të vazhdueshëm të deindustrializimit të Kosovës. Meqë nuk u ofrua kurrfarë kontrolli i efektshëm nga UNMIK-u dhe, veçanërisht, as nga DTI-ja, ndërmarrjeve shoqërore nuk u kanosej rreziku i vuajtjes së sanksioneve, nëse do t'i shfrytëzonin pronat shoqërore për qëllime të ndryshme nga ato të prodhimit.

3. Komercializimi

Pavarësisht nga ndërrimi i politikave lidhur me administrimin e ndërmarrjeve shoqërore, UNMIK-u, që vepronte nëpërmjet DTI-së, e nisi të ashtuquajturin proces i komercializimit. Komercializimi u paramendua si një masë e përkohshme me qëllim të joshjes së investimeve dhe të burimeve të tjera në ndërmarrjet shoqërore të Kosovës²¹. U mendua që ai të jetë më pak se privatizim, i cili në atë kohë u kundërshtua fuqimisht nga Zyra e Çështjeve Juridike të OKB-së.

Në kontekst të komercializimit, DTI-ja ofronte kontrata me koncesion afatgjatë (dhjetë vjet) për ndërmarrjet shoqërore, të zgjedhura nëpërmjet tenderëve publikë. Investuesi fitues merrte të drejtën mbi mjetet fizike dhe fuqinë punëtore të ndërmarrjes shoqërore dhe të drejtën për të funksionuar dhe për ta udhëhequr ndërmarrjen. Megjithatë, investuesi nuk fitonte të drejtën mbi pronësinë e ndërmarrjes ose të mjetëve, gjë që edhe shënon dallimin kyç në mes të komercializimit dhe privatizimit. Të ardhurat nga kontratat me koncesion u mbajtën në mirëbesim, në mënyrë që të plotësoheshin kërkesat e kredituesve ndaj ndërmarrjes. Në përgjithësi, investuesi i ri ishte i liruar nga borxhi i ndërmarrjes, i cili ishte krijuar para komercializimit.

Në anën tjetër, investuesi ishte i detyruar t'i paguante tarifatat vjetore për koncesion, të investojë në ndërmarrje dhe në programet trajnuese për punëtorët, ta ndajë fitimin me ta dhe, në fund të periudhës së kontratës, mjetet e ndërmarrjes t'i kthejë në gjendje pune.

Nga gjithsej 520 ndërmarrje shoqërore, DTI-ja arriti t'i komercializojë vetëm 13 sosh dhe atë me një sukses jo të mjaftueshëm²². Nga 13 ndërmarrje, vetëm 5 janë komercializuar me sukses²³. Si rezultat i kësaj, lulëzimi i prituri ekonomik nëpërmjet komercializimit nuk ndodhi dhe shkalla e papunësisë nuk ra. Përveç kësaj, çështja e pronësisë lidhur me ndërmarrjet dhe pronat shoqërore ende mbeti e hapur dhe e papërcaktuar, duke u bërë kështu një pengesë për investuesit. Në anën tjetër, eksperimenti i komercializimit, edhe pse një eksperiment dëshpërues, ndihmoi në ngritjen e vetëdijes për nevojën e pashmangshme të procesit të privatizimit në Kosovë, nëse duam t'i joshim kapitalin dhe investimet në Kosovë.

4. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore nëpërmjet Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM)

a. Rrethanat ligjore

Privatizimi filloi në fund të vitit 2002, pas shpalljes së Kornizës Kushtetuese dhe themeimit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes. Në pajtim me Kornizën Kushtetuese, edhe autoriteti për administrim të pronës publike, shtetërore dhe asaj shoqërore, edhe rregullimi i pronës publike dhe shoqërore janë kompetenca të rezervuara për PSSP-në²⁴. Megjithatë, PSSP-ja është i detyruar të bashkëpunojë me Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes sa i përket administrimit të pronës publike, shtetërore dhe shoqërore²⁵. Në anën tjetër, Rregullorja mbi Ndërmarrjet Publike dhe Shoqërore kërkon konsultim vetëm nga IPV-të, sipas procedurës së përcaktuar nga Këshilli Ekonomik Fiskal²⁶. Konsultimi, në këtë kontekst, nuk nënkupton arritjen e një marrëveshjeje²⁷. Më saktë, ai nënkupton dhënien e kohës së mjaftueshme Këshillit Ekonomik Fiskal dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, për të bërë vërejtje në projekt-tekstet dhe më pas shqyrtimin me kujdes të këtyre vërejtjeve gjatë shqyrtimit final të tekstit, para miratimit të tij²⁸. Në bazë të këtij autoriteti dhe pas konsul-

timeve të vazhdueshme me IPV-të dhe me Këshillin Ekonomik Fiskal (KEF), PSSP-ja, më 13 qershor të vitit 2002, nxori Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/12, për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM).

b. Administrimi i ndërmarrjeve publike dhe atyre shoqërore

AKM-ja është themeluar, - para së gjithash, - për t'i administruar ndërmarrjet publike dhe ato shoqërore (NP dhe NSH), si garantues për pronarët e tyre²⁹, duke pasur parasysh se çështja e pronësisë është e paqartë dhe e hapur për interpretime të ndryshme.

Ndërmarrjet publike janë të përkufizuara si ndërmarrje në pronësi publike të Krahinës së Kosovës, të komunës ose të organizatave të tjera publike-politike brenda Krahinës së Kosovës, të Republikës së Serbisë ose të Republikës Federative të Jugosllavisë³⁰. Ndërmarrjet shoqërore janë të përkufizuara si ndërmarrje në pronësi shoqërore sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet, Ligjit mbi Punën e Bashkuar të Republikës Federative të Jugosllavisë ose ndonjë igji tjetër të zbatueshëm³¹.

Administrimi, si i tillë, përfshin çdo veprim që AKM-ja e konsideron si të duhur për ruajtjen apo rritjen e vlerës, potencialit ose të qeverisjes së ndërmarrjes në fjalë³². Aksionet e mundshme përfshijnë: a) caktimin dhe zëvendësimin e drejtorëve dhe të menaxherëve të ndërmarrjes, b) marrjen e kontrollit të drejtpërdrejtë mbi ndërmarrjen, c) inspektimin e lokaleve dhe të ndërmarrjeve, d) miratimin e planeve të biznesit dhe atyre investuese, e) miratimin e së drejtës dhe të urdhërësave të ndërmarrjeve, etj³³.

Marrja e kontrollit të drejtpërdrejtë mbi ndërmarrjen nuk konsiderohet si intervenim i rëndomtë. E rëndomtë është që AKM-ja e ushtron mbikëqyrjen e përgjithshme menaxhuese mbi ndërmarrjen, ndërsa strukturat ekzistuese menaxhuese e vazhdojnë administrimin e përditshëm të ndërmarrjes, porse që i nënshrohen pushtetit të AKM-së, siç u tha më lart³⁴.

c. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore

Administrimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe atyre publike nuk ka të bëjë aq shumë me privatizimin. Megjithatë, AKM-ja është e autorizuar t'i themelojë (në emër të ndërmarrjeve shoqërore) një apo disa korporata në formë të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose të shoqërive aksionare dhe t'ua bartë atyre të drejtën dhe fitimet e tërësishme apo të pjesërishtme mbi pronat e ndërmarrjes shoqërore në fjalë. Aksionet e korporatës së krijuar janë pronë e ndërmarrjes shoqërore në fjalë dhe janë nën udhëheqje të AKM-së³⁵. Nën këtë autoritet, AKM-ja ka të drejtë që aksionet t'ia shesë dhe t'ia tjetërsojë (në emër të NSH-së, e cila zyrtarisht i posedon aksionet) pjesërisht ose në tërësi korporatës së sapoformuar³⁶. Të ardhurat nga shitja e aksioneve do të grumbullohen për NSH-në që i ka poseduar aksionet, por ato do të ruhen në mirëbesim nga AKM-ja, për të mirën e kredituesve dhe të pronarëve të ndërmarrjes shoqërore në fjalë. Pas transferimit të

mjeteve dhe pronave të NSH-së në korporatën e re, NSH-ja e mbetur mund të likuidohet³⁷.

Kjo procedurë quhet “procedura e amputimit”³⁸ (spin-off), nëpërmjet të së cilës mendohet të privatizohen ndërmarrjet shoqërore. Në fakt, vetëm mjetet e NSH-së parashihen për t’iu vënë në dispozicion sektorit privat, ndërsa ndërmarrjet shoqërore si të tilla mendohet të likudohen. Megjithatë, kjo formë e zgjedhur e privatizimit nga AKM-ja është e kufizuar vetëm për NSH-të. Ndërmarrjet publike nuk mund t’i nënshtrihen procedurës *spin-off* (të amputimit), por mbeten nën administrim të AKM-së. Përveç kësaj, mjetet e NSH-së nuk do të ndryshojnë, për aq kohë sa statusi i tyre ligjor të jetë i cenuar. Gjatë transferimit në korporatat e sapoformuara, pronat e paluejtshme shoqërore mbeten si të tilla dhe nuk bëhen prona të paluejtshme private.

d. Udhëheqësia e AKM-së

Udhëheqësia e AKM-së përbëhet nga Bordi i Drejtorëve dhe nga drejtori udhëheqës³⁹. Bordi i Drejtorëve (më tej “Bordit”), i cili ka përgjegjësi të përgjithshme për veprimtarinë e AKM-së⁴⁰, përbëhet nga tetë drejtorë, duke përfshirë katër drejtorë ndërkombëtarë dhe katër vendorë⁴¹. Tre nga drejtorët kosovarë janë ministra në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, duke përfshirë këtu edhe ministrin nga komuniteti serb, kurse drejtori i katërt është kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës⁴². Të gjithë drejtorët kosovarë dhe drejtori serb janë të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Drejtorët ndërkombëtarë janë: a) zëvendës PSSP-ja për Rindërtim Ekonomik (BE), i cili është kryetar i Bordit, b) zëvendësi i zëvendësit të PSSP-së për Rindërtim Ekonomik, c) zëvendës PSSP-ja për Administrim Civil (OKB) dhe d) Drejtori udhëheqës i AKM-së⁴³.

Sa i përket procesit të vendimmarrjes brenda Bordit, kuorumi arrihet nëse janë prezentë së paku pesë drejtorë⁴⁴. Në rast të votimit, vendimet merren, thjesht, me shumicë votash të anëtarëve prezentë. Nëse shumica e caktuar kërkohet me rregullore ose me urdhëresë, atëherë janë të nevojshme së paku pesë vota *pro*⁴⁵. Në rast të ndarjes së barabartë të votave, vendimtare është vota e kryetarit⁴⁶.

Drejtori udhëheqës dhe dy zëvendësit e tij caktohen nga Bordi, me emërim nga kryetari⁴⁷. Është detyrë e drejtorit udhëheqës ta drejtojë punën e përditshme të AKM-së, t’i organizojë, t’i caktojë dhe t’i shkarkojë nëpunësit, si dhe t’i përgatisë takimet me Bordin dhe të sigurohet se po zbatohen vendimet e marra nga Bordi⁴⁸. Për ushtrimin e punës së vet, drejtori udhëheqës i raporton krejtësisht dhe vetëm Bordit⁴⁹.

e) Statusi ligjor i AKM-së

AKM-ja është themeluar si një organ i pavarur në pajtim me nenin 11.2 të Kornizës Kushtetuese. Sipas këtij neni, organet e pavarura kanë autoritetin, obligimin dhe përbërjen e përcaktuar me instrumentet ligjore, nëpërmjet të të cilave janë themeluar. Këto organe kryejnë funksionin e tyre, pavarësisht nga IPV-të⁵⁰. Si rrjedhim, AKM-ja nuk mund të konsiderohet si organ i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe

veprimet e saj nuk mund t'i mveshen IPV-ve. Në anën tjetër, Bordi, bashkërisht, dhe drejtorët veç e veç, i përgjigjen PSSP-së, një strukturë ligjore kjo e cila e bën AKM-në organ të UNMIK-ut.

Çështja e statusit ligjor të AKM-së është ngusht e lidhur me çështjen se a do të jetë UNMIK-u përgjegjës nën ligjet ndërkombëtare publike për çdo shkelje të ligjeve ndërkombëtare të bëra nga AKM-ja. Duke marrë parasysh fillimin e privatizimit, të nisur nga Serbia mes viteve 1989 dhe 1999, nuk mund të përjashtohet fakti se persona të caktuar fizikë kanë fituar të drejta private mbi disa ndërmarrje, të cilat në Kosovë ende konsiderohen si prona shoqërore. Privatizimi “sekondar” nga UNMIK-u mund të rezultojë, për shembull, me shpronësimin e shtetasve të huaj, të cilët janë përfitues të privatizimit paraprak të drejtuar nga Serbia. Nëse AKM-ja nuk përmbush kriteret e shpronësimit të njohura me ligjet ndërkombëtare publike (shpronësime vetëm për qëllime publike si dhe kompensime adekuate, të përpikëta dhe të efektshme), ky shpronësim do të jetë shkelje e Ligjit Ndërkombëtar Publik⁵¹. Pastaj shtrohet pyetja se, cila palë do ta ketë përgjegjësinë për dëmshpërblim. Në këtë rast, pyetja konkrete do të jetë nëse Kombet e Bashkuara do të jenë përgjegjëse për veprime të tilla të AKM-së.

Aktualisht, nuk ka as praktikë standarde ndërkombëtare as ligje të mjaftueshme dhe të qarta ndërkombëtare për përgjegjësinë e organizatave ndërkombëtare⁵². Prandaj, parimet e zbatuara për përcaktimin e përgjegjësive ndërkombëtare të shteteve mund të përdoren nëpërmjet analogjisë. Këto parime kërkojnë që të ketë shkelje të ligjeve ndërkombëtare publike dhe që veprimi që ka shkaktuar këtë shkelje të ligjit ta ngarkojë shtetin. Kombet e Bashkuara, që veprojnë nëpërmjet Këshillit të Sigurimit, e kanë themeluar UNMIK-un si drejtues paqeruajtës, i cili njihet si organ i Kombeve të Bashkuara. Me pëlqimin e Kombeve të Bashkuara, UNMIK-u e formoi AKM-në si nënorgan. Si rrjedhojë, çdo veprim i AKM-së, duke përfshirë shkeljen e ndonjë ligji ndërkombëtar, i mveshet Kombeve të Bashkuara, pavarësisht nga fakti se AKM-ja është institucion i pavarur sipas Kornizës Kushtetuese dhe pavarësisht nga kapitalizimi prej 10 milionë €, që mendohet t'i heqë detyrimet e UNMIK-ut the të OKB-së nga përgjegjësitë.

f. Mjetet juridike

Në mënyrë që të sigurohen mjete të efektshme ligjore lidhur me procesin e privatizimit, UNMIK-u, me anë të Rregullores nr. 2002/13, të datës 13 qershor 2002, themeloi Dhomen e Veçantë të Gjykatës së Lartë të Kosovës për rregullimin e çështjeve të AKM-së. Dhoma e Veçantë ka autoritet ekskluziv dhe primar mbi të gjitha paditë kundër AKM-së⁵³. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në:

- Sfidimin e vendimeve ose veprimeve të tjera të AKM-së;
- Paditë kundër AKM-së për humbjet financiare, si pasojë e vendimeve dhe veprimeve të marra nga AKM-ja, si rezultat i rolit të saj si administratore e një

ndërmarrjeje ose një korporate;

- Paditë kundër ndërmarrjes ose korporatës që është nën autoritetin administrativ të AKM-së;

- Paditë që përfshijnë njohjen e së drejtës, zotërimit ose fitimit mbi pronën në posedim ose nën kontrollin e ndërmarrjes apo të korporatës që është nën autoritetin administrativ të AKM-së⁵⁴;

Asnjë gjykatë tjetër e Kosovës nuk mund të ushtrojë autoritet mbi këtë kategori padish⁵⁵. Megjithatë, Dhoma e Veçantë mund t'ia përcjellë paditë si dërgesë gjykatës vendore, e cila do ta kishte autoritetin mbi këto padi sikur Dhoma e Veçantë të mos ekzistonte⁵⁶. Në rast të dërgesave të tilla, ankesat për vendimet e marra nga gjykata vendore mund të dërgohen në Dhomën e Veçantë⁵⁷. Megjithëse Dhoma e Veçantë në rastet normale vepron si instancë e parë dhe e fundit ligjore, ajo në rastet e dërgesave vepron si organ i ankesave gjyqësore (funksion i dyfishtë).

Dhoma e Veçantë është e përbërë nga grupi prej pesë gjykatësish, tre prej të cilëve janë të huaj dhe dy vendorë⁵⁸. Të gjithë gjykatësit janë të caktuar nga PSSP-ja, pas konsultimeve paraprake me kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës⁵⁹. Një nga gjykatësit e huaj është i caktuar nga PSSP-ja, si gjykatës kryesor në Dhomën e Veçantë⁶⁰. Vendimet e Dhomës së Veçantë, kur shqyrton ndonjë padi apo vendos mbi një ankesë, kërkojnë votat mbështetëse të së paku tre gjykatësve⁶¹.

g. Vërejtjet kritike

Kur Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës e miratuan projektregulloren mbi themelimin e AKM-së, asnjëra nga të dy këto institucione nuk e morën sa duhet në konsiderim faktin se korporatat e sapoformuara të Kosovës mund të blihen – në mënyrë të ligjshme – nga Qeveria e Serbisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndërmjetësim (p.sh. nëpërmjet të një kompanie private). Nuk ekziston asnjë nen në rregullore që do ta ndalonte shitblerjen e tillë. Ka të ngjarë që procesi i privatizimit t'i nënshtrohet një rreziku serioz sikur aksionisti kryesor i korporatës së sapoformuar në Kosovë të jetë Qeveria e Serbisë.

Përveç kësaj, asnjëra nga institucionet e lartpërmendura kosovare nuk e kanë kuptuar qartë se të ardhurat e krijuara nga shitja e aksioneve të korporatave të reja nuk do të përdoren për projektet e zhvillimit të infrastrukturës në Kosovë, por do të shërbejnë për pagimin e borxheve ndaj kredituesve nga ndërmarrjet e mëparshme shoqërore. Shumica e këtyre kredituesve janë kompani serbe ose individë serbë. Si pasojë, Kosova vetë nuk do të ketë dobi nga të ardhurat e krijuara prej procesit të privatizimit (AKM-ja është e liruar edhe nga pagesat e taksave për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës), ndërsa Serbia do të ketë dobi. Në një skenar më ekstrem, kompanitë serbe dhe individët serbë mund të lejohen të blejnë aksione nga korporatat e sapoformuara kosovare me paratë që i marrin si kreditues nga ndërmarrjet e mëparshme shoqërore, ose së paku të

kompensohen me blerjen e aksioneve në korporatat e reja me ato para që u detyrohen nga ndërmarrjet e mëparshme shoqërore. Natyrisht, kjo situatë është krejtësisht e kundërt me atë që Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes kanë paraparë për këto të ardhura. Duhet menduar për mundësitë e përdorimit të përfitimeve nga shitja e aksioneve për zhvillimin e infrastrukturës së Kosovës, pavarësisht nga vonesat dhe vlerësimet e pavlefshme teorike rreth asaj se kush mund të jetë pronar ligjor i pronave shoqërore. Kosova është në një situatë të palakmueshme ekonomike, gjë që kërkon veprim të shpejtë dhe të vendosur. Përndryshe, kjo situatë do të mund të kalojë edhe në trazira shoqërore, prandaj edhe politike, gjë që do të kërcënonte vetë Misionin e Kombeve të Bashkuara.

Këto zhvillime dhe këta skenarë të mundshëm duhet të monitorohen, të kontrollohen dhe të harmonizohen me IPV-të, nëse duam t'i shmangim dallimet serioze politike ndërmjet IPV-ve dhe UMIK-ut. Me fillimin e privatizimit dhe racionalizimit brenda korporatave, situata do të mund të bëhej politikisht e rrezikshme, kurse numri i të papunëve do të rritej. Populli kosovar dhe IPV-të janë duke pritur një valë të re punësimi nëpërmjet procesit të privatizimit, një shpresë kjo që, sipas të gjitha parashikimeve, do të përfundojë me zhgënjim. Ofrimi i informatave të sakta IPV-ve mbi mundësitë e zhvillimit dhe pasojat nga procesi i privatizimit mund të ketë efektin e amortizimit të konflikteve dhe të shërbejë për shmangien e konfrontimeve të ardhshme politike ndërmjet UNMIK-ut dhe IPV-ve.

Një tjetër situatë e palakmueshme është krijuar me vendimin që autoritetet udhëheqëse të AKM-së t'i përfshijnë të gjitha ndërmarrjet dhe pronat brenda fushëveprimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/45, të datës 11 gusht 2000, mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës⁶². Pronat brenda fushëveprimit të kësaj rregulloreje përfshijnë të gjitha pronat komunale, që nënkupton të gjitha tokat dhe ndërtesat e pronësuara ose të okupuara nga komuna⁶³. Shpjegimi i saktë do të rezultonte me përjashtimin e menjëhershëm të komunave nga administrimi i tokave dhe i ndërtesave të veta. Kjo, madje, do të përfshinte edhe përjashtimin e planifikimit urban dhe hapësinor nga kompetencat e komunave, si dhe kalimin e kësaj kompetence AKM-së. Në fakt, prona komunale nuk do të ekzistonte më. Kjo rregullore do të kundërvihej shumë keqas me qëllimet e procesit të privatizimit të parashikuar, si dhe do të shkelte të drejtën e autoritetit komunal për t'i udhëhequr një pjesë të madhe të punëve publike, duke përfshirë këtu edhe administrimin dhe mirëmbajtjen e pronës komunale⁶⁴. Meqë formulimi dhe fryma e dispozitës në fjalë e kundërshtojnë njëra-tjetrën, do të jetë i domosdoshëm një interpretim autoritativ i lëshuar nga PSSP-ja, në mënyrë që të qartësohet situata ligjore. Përndryshe, konfrontimi serioz ndërmjet AKM-së dhe komunave do të jetë i pashmangshëm.

Sa i përket Dhomës së Veçantë, vetë përbërja e saj tregon dominimin e gjykatësve ndërkombëtarë mbi ata vendorë. Dominimi i ndërkombëtarëve është, po ashtu, i theksuar në Rregulloren e procedurës së Dhomës së Veçantë⁶⁵, e cila ka paraparë formimin e një infrastrukture administrative tërësisht të shkëputur nga pjesa tjetër e Gjykatës

Supreme. Dhoma e Veçantë do ta kishte sekretarinë e veçantë dhe sekretarin e gjykatës, i cili do të duhej të ishte ndërkombëtar. Sekretari individual i gjykatës, sekretaria e veçantë e gjykatës dhe rregullat e veçanta të procedurës tregojnë se Dhoma e Veçantë, në thelb, ka shumë pak të bëjë me Gjykatën Supreme të Kosovës. Në fakt dhe në përmbajtje, ajo është më tepër një Gjykatë e veçantë ndërkombëtare, e cila vetëm formalisht i është bashkëngjitur Gjykatës Supreme të Kosovës. Por, kjo situatë përmban një rrezik juridik për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe për vetë Kosovën, meqë Gjykata Supreme konsiderohet organ i IPV-ve. Si pasojë, IPV-të mund të jenë përgjegjëse për veprimet e Dhomës së Veçantë, megjithëse veprimet e saj janë jashtë kontrollit dhe ndikimit të IPV-ve. Duke marrë parasysh mundësinë që Kosova të jetë për momentin një shtet *in statu nascendi* (shtet që po lind)⁶⁶ dhe faktin se Dhoma e Veçantë do të merret me çështjet delikate juridike, siç është rasti i largimit të shtetasve të huaj, në një të ardhme të afërt ose të largët, Kosova mund të konsiderohet e përgjegjshme sipas ligjeve ndërkombëtare publike për ato veprime që do të ishin jashtë kontrollit dhe jashtë ndikimit të saj.

IV. Privatizimi i pronave të paluejtshme shoqërore

1. Histori

Siç u theksua më lart, veprimtaritë e ndërmarrjeve shoqërore, për momentin, janë pak a shumë të kufizuara rreth dhënies me qira të pronave të veta, që janë jashtë shfrytëzimit për prodhim industrial dhe bujqësor, për çka kanë qenë të planifikuara. Si pasojë, vlera e NSH-së nuk është vetë NSH-ja, por trojet e saja dhe deri-diku edhe objektet. Disa raste të komercializimit kanë dëshmuar se investuesit privatë kanë nënshkruar marrëveshje koncesuale me DIT-ën, në mënyrë që të kenë qasje ndaj trojeve të ndërmarrjeve shoqërore, por jo edhe t'i shfrytëzojnë objektet e NSH-ve për prodhime industriale dhe bujqësore, për çka kanë qenë të destinuara.

Kur AKM-ja ta transferojë pronën e NSH-së në korporatën e sapoformuar, kjo e fundit i fiton vetëm pronat e paluejtshme shoqërore. Natyra e paluejtshme të tjetërsuara nuk do të ndryshojë, thjesht, vetëm me tjetërsimin e tyre prej NSH-së të korporatat private, sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12. Si pasojë, korporatat e sapoformuara do ta gëzojnë të drejtën e përdorimit të pronave të paluejtshme shoqërore që i janë transferuar, por jo edhe të pronësisë private. Sipas ligjeve të zbatueshme, zotëruesit e së drejtës për përdorim lejohen t'i përdorin dhe t'i shfrytëzojnë pronat e paluejtshme. E meta kryesore e së drejtës për përdorim është se vështirë mund të bëhet tjetërsimi i saj te personat e tretë dhe brenda saj nuk mund të themelohen ngarkesat e vërteta (hipoteka, pengju). Prandaj, korporatat e sapoformuara nuk do të kenë mundësi t'i shesin paluejtshmëritë ose t'i lënë ato peng (p.sh. për hua bankare ose për monetarizimin e tyre), nëse kjo kërkohet. Kjo bën që e drejta për përdorim në formën e tanishme të mos jetë joshëse për qëllimet komerciale, sidomos në kontekst të korporatës private,

e cila do të duhej të funksiononte në kushte të tregut të lirë dhe të konkurrencës. Pa një mundësi të efektshme për tjetërsimin dhe ngarkimin e pronave të paluejtshme, ato do të jenë të pavlefshme në kushtet e tregut të lirë.

Në sistemin e tanishëm juridik lidhur me privatizimin, nuk është e qartë nëse investuesit e huaj dhe ata vendorë mund të joshen për t'i blerë aksionet nga korporatat e sapoformuara dhe kësajsoj të sigurojnë një proces të suksesshëm të privatizimit.

2. Veprimtaritë e tanishme legjislative

Duke qenë plotësisht e vetëdijshme rreth problemeve të lartpërmendura, Shtylla IV e UNMIK-ut ka inicuar përgatitjet për një projektregullore mbi të drejtën e përdorimit të pronave të paluejtshme shoqërore.

Fillimisht, Zyra e këshilltarëve ligjorë (ZKL) të UNMIK-ut e ka bërë të qartë se transformimi i plotë i së drejtës për përdorim të pronave të paluejtshme shoqërore në një pronësi krejtësisht private nuk do të pranohet. Çështja e pazgjidhur e statusit përfundimtar të Kosovës do t'ia mohojë UNMIK-ut kompetencat për transformime të tilla. Nocioni i paqartë i pronës shoqërore do t'i vërë Kombet e Bashkuara në një rrezik të pamasë të përgjegjësive lidhur me ish-Jugosllavinë për veprimet e mundshme *ultra vires* ose shkeljen e mundshme të të drejtës sovrane të ish-Republikës Jugosllave.

Duke pasur parasysh këtë, Zyra e këshilltarëve ligjorë në diskutimet paraprake ka miratuar “reformimin” ose “ridefinimin” e së drejtës për shrytëzimin e pronës shoqërore. Në bazë të kësaj, Shtylla IV e UNMIK-ut ka ridefinuar konceptin e së drejtës për përdorim në draftin e vet me këto dy karakteristika kryesore:

- E drejta për përdorim do të përfshijë të drejtën për posedim, për përdorim, për tjetërsim, për vënien e hipotekave në pronësi⁶⁷; dhe
- Zotëruesi i këtyre të drejtave për përdorim do të ketë të drejtë t'i ushtrojë të drejtat e lartpërmendura në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vjetësh, që nga data kur projektregullorja hyn në fuqi⁶⁸.

Çdo tjetërsim ose vënie e hipotekës mbi të drejtën e përdorimit duhet të bëhet me shpresë dhe të jetë në përputhje me kërkesat për regjistrim dhe ato procedurale për tjetërsimin ose për vënien peng të paluejtshmërisë⁶⁹. Megjithatë, transferi ose vënia e hipotekës mbi të drejtën e përdorimit nuk do ta zgjatë dhe as nuk të ndikojë në ndonjë mënyrë tjetër mbi afatin prej nëntëdhjetë e nëntë vjetësh⁷⁰.

Termi “pronë” në përdorimin e mësipërm nënkupton çdo lloj të tokës, duke përfshirë këtu çdo objekt mbi të, si dhe pjesët e saj të vlerësuara si pronë shoqërore⁷¹. Zotëruesi i së drejtës për përdorim nënkupton çdo person ose trup juridik ose fizik, i cili është regjistruar në mënyrë të rregullt në dosjet kadastrale ose në dokumentet e tjera të lëshuara nga gjyqi, si zotërues i së drejtës për përdorim të pronës shoqërore⁷².

Vërejtjet kritike

Synimi i një ridefinimi të tillë të së drejtës për përdorim është që të vihet sa më afër së drejtës mbi pronën private, por pa e bërë transformimin e njëjmentë në pronë private. Pra, kjo gjë do të ishte e ngjashme me konceptin për dhënie të pronës me qira, i cili njihet nëpërmjet ligjit të zbatueshëm. Sipas definimit të tillë, e drejta e përdorimit të pronës do të bëhet më joshëse për qëllime investimi, meqë do të ishte plotësisht e tjetërsueshme dhe e ngarkueshme.

Çështja është se, a do të jetë transformimi i së drejtës për përdorim të pronës së paluejtshme shoqërore në pronë private, në aspektin ligjor, jashtë kompetencave të UNMIK-ut? Prona shoqërore, si e tillë, pothuajse nuk ekziston më në asnjërin shtet të dalë nga ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ). Në Slloveni, Ligji mbi Privatizimin e Pasurisë së Paluejtshme të Pronës Shoqërore, i vitit 1997, i transformoi pronat e paluejtshme në pronat private. Çdo zotërues i së drejtës për shfrytëzim mori pronësinë private mbi pronat e paluejtshme mbi paluejtshmëri të caktuara. Të njëjtat parime janë zbatuar në Kroaci, me Ligjin mbi Pronësinë dhe të drejtat e lidhura me të, në vitin 1996. Për dallim prej Sllovenisë dhe Kroacisë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM) i bëri transformimet duke u mbështetur në Ligjin mbi Transformimin e Ndërmarrjeve Shoqërore, të vitit 1993, prej pronave të paluejtshme shoqërore në pronat shtetërore. Sidoqoftë, nocioni i pronës shoqërore u zhduk. Edhe në Serbi, Ligji mbi Tokat Ndërtimore, i vitit 1995, i konsideron tokat urbane si pronat shtetërore dhe me të e zhduk nocionin e pronës shoqërore. Kurse, me Ligjin mbi Privatizimin, të vitit 2001, Serbia, po ashtu, ka nisur privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore. Edhe Mali i Zi, po ashtu, i konsideron pronat e paluejtshme, dikur shoqërore, si pronat shtetërore. Kjo na lejon të nxjerrim përfundimin se në të gjitha shtetet pasuese të ish-Jugosllavisë, pronat e paluejtshme shoqërore, ose janë transformuar në pronat private ose trajtohen si pronat shtetërore. Por, të paktën, nocioni i paqartë i pronës shoqërore është eliminuar përfundimisht. Në Kosovë është vetëm Rregullorja e UNMIK-ut Nr.1999/24, mbi Ligjet e Zbatueshme në Kosovë, ajo që po lejon të ekzistojë edhe më tutje “fantazma” e pronës së paluejtshme shoqërore. Rivendosija e sistemit ligjor të para vitit 1989, është vetëm një konstruksion artificial ligjor, i cili, të paktën në sferën e ligjit civil dhe komercial, është tërësisht i vjetëruar dhe nuk ka të bëjë fare me realitetin dhe zhvillimin ligjor të dekadës së kaluar. Sikur UNMIK-u të mos vendoste që Ligji i zbatueshëm në Kosovë të jetë ligji në fuqi para vitit 1989, atëherë problemi i pronës shoqërore sot nuk do të ishte problem. Meqë UNMIK-u e ka ringjallur vetë “fantazmën” e pronës shoqërore, është e pakuptueshme pse do të ishte jashtë mandatit të UNMIK-ut që ta rregullojë punën e pronave të mbetura shoqërore. Kur UNMIK-u krijoi taksa të veçanta, doganën, sistemin policor dhe atë administrativ, kur e zëvendësoi dinarin me markën gjermane, e më vonë me euro, kur e krijoi Bankën Qendrore (Autoritetin Bankar dhe të Pagesave) për Kosovën, kur njohu karta të ndryshme identifikimi, regjistrime të ndryshme qytetarësh, targa të ndryshme automjetesh, e madje edhe dokumente udhëtimi për kosovarët, kur i organi-

zon dhe i përcjell zgjedhjet në mënyrë të veçantë e të ndara nga zgjedhjet në tërë RFJ-në dhe, përfundimisht, kur e ndryshoi tërë sistemin kushtetues dhe ligjor në Kosovë pa shkelje të sovranitetit të RFJ-së, atëherë pse transformimi i pronës shoqërore në pronë private do ta shkelte sovranitetin e RFJ-së?

Megjithatë, konsiderimi i së drejtës për shfrytëzimin e pronave të paluejtshme shoqërore, si rrjedhojë e ridefinimit të paraparë nga Shtylla IV e UNMIK-ut do të jetë se, me draft rregulloren që do të hyjë në fuqi, edhe ndërmarrjet shoqërore ekzistuese automatikisht do ta siguronin të drejtën “moderne” të përdorimit të pronës, plotësisht të tjetërsueshme dhe të hipotekueshme. Më pas, kjo e drejtë moderne e përdorimit do të transferohet në korporatën e sapoformuar. Do të ishte e padrejtë që të supozojmë se të gjitha ndërmarrjet shoqërore të tanishme do të privatizohen. Më mirë është të llogarisim se shumica e këtyre NSH-ve do të likudohen. Prandaj, pyetja është se, a do ta gëzojnë të gjitha NSH-të të drejtën moderne të përdorimit, apo vetëm korporatat e sapoformuara nga NSH-të e privatizuara me sukses do ta kenë këtë të drejtë moderne të përdorimit? Qëllimi dhe fryma e procesit të privatizimit i japin më shumë mundësi alternativës së dytë.

Përveç kësaj, duhet të theksohet se komunat janë krejtësisht të përjashtuara nga procesi i tjetërsimit të mjeteve në korporatat e sapoformuara dhe procesi i ripërkufizimit të së drejtës për përdorim të pronës shoqërore. Kjo është një vazhdimësi e veprimeve të procesit të “shkomunalizimit” sa i përket administrimit të pronës shoqërore, proces ky i filluar nga DTI-ja, në vitin 2000. Duke marrë parasysh rolin e mëparshëm të komunave në administrimin e pronave të paluejtshme shoqërore, qasja e tanishme krejtësisht i anashkalon komunat.

Aspekt tjetër, që është lënë tërësisht pas dore, është ai i kompensimit të dëmit. Siç u tha më lart, shumë zotërues të pronave janë shpronësuar pa kompensim, për shkak të vlerësimit si armiq të shtetit ose si armiq politikë. Në shumë raste vihet në dyshim nëse është bërë kompensimi i mjaftueshëm dhe nëse është respektuar procesi përkatës. Të gjitha këto raste lejojnë dëmshpërblimin e pronarëve të mëparshëm. Me draft rregulloren e tanishme, do të legalizohet shpronësimi dhe nacionalizimi i paligjshëm i pronave private, si dhe transformimi i pronës shoqërore. Megjithatë, dëmshpërblimi është një çështje e kosovarëve, i cili për shkak të ndërlikimit dhe pengesave që ka, nuk duhet të shpërfillet e të lihet anash nga UNMIK-u⁷³.

Përfundimisht, nuk është e qartë se cilin rol do ta luajnë Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPV) në procesin e kompensimit të dëmit. Ridefinimi i së drejtës për shfrytëzim të pronave të paluejtshme shoqërore mund të interpretohet si masë që bie nën kaptinën 8.1 (g) të Kornizës Kushtetuese, që d.m.th. administrimin e pronës publike, shtetërore dhe asaj shoqërore. Kompetencat për administrimin e pronave të tilla janë të rezervuara nga PSSP-ja, por kërkojnë bashkëpunim me IPV-të. Bashkëpunimi është dukshëm më shumë sesa vetëm konsultimi i thjeshtë, por ai nuk i dikton dhe as

nuk i zvogëlon kompetencat e PSSP-së dhe nuk u jep IPV-ve të drejtën për veto. Megjithatë, ridefinimi i së drejtës për shfrytëzimin e pronave të paluejtshme shoqërore ka rëndësi të madhe për sistemin ekonomik të Kosovës dhe për të ardhmen e ekonomisë së Kosovës. Gjatë këtij procesi, IPV-të, si të vetmet institucione të zgjedhura në mënyrë demokratike nga populli i Kosovës, duhet ta luajnë rolin kryesor. Vetadministrimi kuptimplotë dhe i pavarur, siç garantohet me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS i OKB-së) përfshin, veç tjerash, një shkallë të lartë të vetëvendosjes ekonomike, që d.m.th. *si* dhe *nga kush* do të shfrytëzohen burimet ekonomike të vendit. Kjo do t'u siguronte IPV-ve *de facto* të drejtën për veto. Nëse flasim realisht, PSSP-ja kurrë nuk do të jetë në gjendje ta zbatojë ridefinimin e së drejtës për shfrytëzim, po qe se do të haste në kundërshtime të vazhdueshme nga ana e IPV-ve. Prandaj, pëlqimi i IVP-ve për të drejtën për shfrytëzim është një nga elementet themelore që do të kërkonte, rrjedhimisht, edhe pjesëmarrjen e plotë të IPV-ve në procesin politik.

Fatkeqësisht, IPV-të deri tani nuk ia kanë dalur të formulojnë një politikë formale në procesin e privatizimit. Ato kanë marrë rolin reagues, duke u fshehur pas kufizimeve të Kornizës Kushtetuese dhe, kështu, duke mos e kuptuar se vendimet politike që merren sot do ta përcaktojnë sistemin ekonomik të Kosovës, ndoshta për dekadat e ardhshme. Vlerësimet afatshkurtëra politike të partive politike kosovare dhe rivaliteti ndërmjet tyre, e pengojnë rrugën e formulimit racional dhe të arsyeshëm për pozitën politike të IPV-ve mbi privatizimin, duke i marrë parasysh interesat afatgjate të popullit të Kosovës. Në të vërtetë, IPV-të vetëm i marrin draft rregulloret nga PSSP-ja, bëjnë komente, kërkojnë disa ndryshime, përfshirja e të cilave në tekst varet nga PSSP-ja, dhe pastaj PSSP-ja e miraton atë tekst. IPV-të nuk konfrontohen me PSSP-në dhe me komunitetin ndërkombëtar për një projekt zyrtar vetanak të IPV-ve (ose të paktën me një ide) për privatizim, të mbështetur në argumente ligjore, e që e shpreh vullnetin e popullit të Kosovës të përfaqësuar legjitimisht nga IPV-të. Nëse partitë politike kosovare nuk arrijnë ta tejkalojnë drejtimin shkurtpamës politik, atëherë ndodhitë mund t'i shkelin IPV-të dhe t'i kthejnë ato në të pavlefshme ose, së paku, t'i shpallin si përfaqësuese joserioze të popullit të Kosovës në raport me UNMIK-un dhe me komunitetin ndërkombëtar.

V. Përfundim

Prezantimet e përvijuara të procesit të privatizimit në Kosovë arritën në këto përfundime:

Ngecja e prodhimit bujqësor dhe industrial në Kosovë e shndërroi ekonominë e Kosovës në ekonomi të prirë drejt importit me një deficit tregtar të pamasë. Ky deficit tregtar nuk mund të vazhdojë për një të ardhme afatmesme ose afatgjatë.

Kosova është në mes të procesit të deindustrializimit, gjë që po rezulton me një politikë të dhënies me qira të pronave të ndërmarrjeve shoqërore.

Politika e centralizimit e DTI-së nëpërmjet përjashtimit të komunave nga mbikëqyrja administrative e ndërmarrjeve shoqërore, rivendosja e socializimit të kështillit të punëtorëve në një mjedis politik josocialist, si dhe mangësitë administrative të vetë DTI-së, krijuan në Kosovë një mjedis ku NSH-të mund të funksionojnë pa qenë nën ndonjë mbikëqyrje administrative të efektshme. Kjo rezultoi me politikën e deindustrializimit të Kosovës dhe dhënien me qira të pronave të NSH-ve.

Komercializimi i NSH-ve, i ndërmarrë nga DTI-ja, është dëshmuar si dështim, ndonëse e ka ngritur vetëdijen për nevojën e privatizimit të NSH-ve.

Privatizimi i tanishëm i NSH-ve nën AKM-në, nëpërmjet procesit të amputimit (*spin-off*) vështirë se do t'i tërheqë kapitalin dhe investimet e huaja dhe ato vendore për Kosovën, derisa pronat e paluejtshme shoqërore dhe e drejta për shfrytëzim të tyre të mos privatizohen.

Planet aktuale për privatizimin e pronave të paluejtshme shoqërore nuk i përfshijnë sa duhet IPV-të, nuk marrin parasysh interesat dhe rolin e komunave dhe nuk marrin parasysh aspektet e kompensimit të dëmit nga shpronësimi ilegal i pronave private. Ato, po ashtu, janë të kufizuara në ridefiniminin e së drejtës së tanishme për përdorim dhe nuk i shterojnë të gjitha mundësitë ligjore dhe politike për tjetërsimin e tyre në një pronësi të plotë.

Rekomandimet e politikave

Metoda *spin-off* (e amputimit) për privatizim të NSH-ve, tashmë është kodifikuar dhe vështirë se mund të ndryshohet pa shkaktuar ndonjë “tërmet” juridik ose politik. Megjithatë, privatizimi i pronave të paluejtshme shoqërore, dhe me këtë edhe e drejta për shfrytëzim, janë ende çështje të hapura për diskutim dhe këtu do të përqendrohen rekomandimet politike.

1. Transformimi i së drejtës për shfrytëzim në pronësi private (mundësia 1)

Si mundësi e parë, pavarësisht nga kundërshtimi i Zyrës së këshilltarëve ligjorë (ZKL), IPV-të, si të vetmet institucione të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe legjitime nga populli i Kosovës, duhet ta kërkojnë transformimin e së drejtës për shfrytëzim nga pronat e paluejtshme shoqërore në pronësi të plotë private, duke e ndjekur shembulin e Sllovenisë dhe të Kroacisë. Një zgjidhje e tillë do të ishte e ligjshme dhe e përshtat-

shme për joshje të investimeve të huaja dhe atyre vendore. IPV-të mund të argumentojnë se vetadministrimi i vërtetë dhe kuptimplotë, ashtu siç garantohet me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së (1999), do t'i jepte popullit të Kosovës të drejtën për të vendosur mbi strukturën e sistemit të vet juridik dhe ekonomik. IPV-të, si të vetmet institucione demokratike dhe ligjore – duke kërkuar privatizimin nëpërmjet transformimit në pronësi private - do ta shprehnin vullnetin e popullit të Kosovës.

2. Ridefinimi i së drejtës për përdorim (mundësia 2)

Nëse IPV-të nuk arrijnë t'i jetësojnë objektivat e mundësisë së parë, atëherë ato duhet të sigurojnë pjesëmarrje të efektshme në procesin e ridefinimit të së drejtës aktuale për shfrytëzim.

a. Aspektet procedurale

Që nga fillimi, IPV-të dhe komunat duhet të përfshihen aktivisht në procesin e marrjes së vendimeve politike, pa sfiduar autoritetin e PSSP-së. Pjesëmarrja e këtyre organizmave do të ndikonte (cilatdo qofshin rezultatet) në legjitimitetin e vendimeve përfundimtare politike mbi metodën e privatizimit dhe do ta siguronte një pëlqim nga të gjitha palët e përfshira (legjitimim me pjesëmarrje). Procesi, i cili nuk do t'i lejonte IPV-të dhe komunat që t'i shprehin interesat, nevojat dhe brengat e veta, është afër mendsh se do të përfundonte me një ballafaqim politik, nëse jo me një kundërshtim dhe pengesë të plotë politike. Për rrjedhojë, rekomandohet që të themelohet një grup i përbashkët punues, i përbërë nga përfaqësues të UNMIK-ut, të IPV-ve dhe të komunave, në mënyrë që ky grup të propozojë zgjidhje për një vendim politik mbi privatizimin e pronave të paluejtshme shoqërore dhe të përgatisë, si hap i ardhshëm, projektlegjislationin e domosdoshëm.

b. Aspektet qenësore

Privatizimi i pronës së paluejtshme shoqërore në Kosovë dë të kërkonte harmonizimin e elementeve të mëposhtme:

- Krijimin e korporatave komerciale të efektshme;
- Sigurimin e vetadministrimit të efektshëm të komunave;
- Dëmshpërblimin për pronat e nacionalizuara.

Modeli gjerman “*Treuhand-Model*”, nëpërmjet të të cilit Gjermania Federale, pas ribashkimit me Gjermaninë Lindore, bëri privatizimin e pronave të popullit (“*Volkseigentum*”), e që është koncept i ngjashëm me këtë të pronave shoqërore në Kosovë, ofron një shembull të dobishëm si elementet e lartpërmendura mund të harmonizohen tërësisht.

Procesit të privatizimit në Gjermani i printe parimi se ndërmarrjet e privatizuara mund t'i gëzojnë në formë të pronësisë private, ato paluejtshmëri të cilat ishin të domos-

doshme për veprimtari komerciale të këtyre ndërmarrjeve. Paluejtshmëritë e tjera do t'u mbeteshin komunave dhe/ose do të shërbenin për qëllime komunale vetadministrative ose do të ishin në dispozicion për kompensim të dëmit për pronat private të nacionalizuara më parë. Kjo, e vënë në gjuhën e një liste rendore, do të thotë kështu: ndërmarrjet private do të trajtoheshin së pari, e pastaj kërkesa për kompensim dhe të tjerat do t'u mbeteshin komunave. Përvetësimi *bona fide* (i mirëfilltë) i pronësisë së nacionalizuar, megjithatë, do ta përjashtojë kërkesën për rikthim.

Këto parime mund të aplikohen edhe në Kosovë. AKM-ja do të vendoste se cilat prona të paluejtshme komerciale janë të nevojshme për një korporatë të sapoformuar dhe këto paluejtshmëri më pas do t'i transferoheshin kësaj shoqërie aksionare (korporate). Shoqëria e sapoformuar aksionare më pas do të gëzonte ose pronësi private (mundësia 1) ose të drejtën për përdorimin plotësisht të transferueshëm dhe të ngarkueshëm të pronave (mundësia 2). Vendimet e AKM-së do të vareshin nga vërejtjet e komunës ose të personave të tjerë të ndikuar nga vendimet e marra, para Dhomës së Veçantë. Sa i përket rivendosjes, mund të themelohet komisioni i përbërë nga IPV-të dhe nga komunat, për të vendosur rreth çështjes së rivendosjes. Vendimet nga ky organ mund të jenë sfidë e drejtpërdrejtë për Gjykatën Supreme të Kosovës.

Ky skenar ofron vetëm një mundësi si të mund të harmonizohen elementet e përfshira. Megjithatë, ai mund të jetë një ushtrim i mirë për mendim dhe mund ta lehtësojë konceptimin e më shumë zgjidhjeve të përsosura.

3. E drejta tregtare dhe civile në përgjithësi

Cilado metodë e privatizimit të jetë zgjedhur përfundimisht, ringjallja e pritur dhe e domosdoshme ekonomike nuk do të ndodhë, nëse i gjithë sistemi i së drejtës tregtare dhe civile nuk garanton siguri ligjore për investues të mundshëm, të jashtëm dhe vendorë. Fillimisht, kjo kërkon krijimin e një qeverisjeje të efektshme dhe të qartë të së drejtës pronësore, duke përfshirë regjistrin e besueshëm dhe të rregullt të të drejtave pronësore, pastaj një rregullore të përsosur mbi hipotekën dhe pengun⁷⁴ dhe, në përgjithësi, një marrëveshje moderne dhe legjislacion mbi procedurën civile/tregtare.

Këto instrumente, së bashku me një sistem profesional, neutral dhe të efektshëm ligjor, vendimet e të cilit janë të ekzekutueshme me përpikëri dhe efikasitet, do të ofronin sigurinë dhe besueshmërinë e duhur ligjore për investuesit dhe për institucionet financiare dhe atë: a) për investimin e kapitalit në projektet e shtrenjta industriale dhe bujqësore, dhe b) për ofrimin e huave me afat dhe normë kamate të pranueshme, kështu që do të derdheshin paratë në sektorin industrial dhe atë bujqësor.

Si shtesë, do të kërkohej një ligj bashkëkohor mbi falimentimin, në mënyrë që të mund të likuidoheshin dhe të shkatërroheshin NSH-të e dështuara, të cilat nuk ia vlen të privatizohen. Paluejtshmëritë e këtyre NSH-ve duhet t'u ofrohen kompanive private, sidomos ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla, nëpërmjet tenderëve publikë dhe pas rregullimit të lëndëve gjyqësore të kredituesve të mëparshëm të NSH-ve.

4. Zbatimi me efektshmëri i ligjit

Më në fund, si UNMIK-u, ashtu edhe autoritetet lokale kanë treguar se nuk janë të gatshëm t'i përdorin mjetet ligjore që kanë në dispozicion. Zgjidhja më e mirë politike dhe juridike do të ishte po aq e pafrytshme, nëse nuk zbatohen sanksionet dhe nëse mjetet juridike kundër thyerjeve të ligjit nuk tregojnë efektshmëri. Meqë shumë dokumente ligjore të UNMIK-ut kanë mbetur vetëm si ligje të shkruara në libër dhe asnjëherë nuk janë zbatuar⁷⁵, ka shqetësime se Kosova do të pësojë një legjislacion “të mirë” të privatizimit, i cili nuk do të zbatohet në praktikë. Prandaj, është më se e rëndësishme që të gjitha institucionet administrative dhe juridike, të përfshira në procesin e privatizimit, të jenë të efektshme dhe efikase në zbatimin e ligjeve.

Vetëm një qasje gjithëpërfshirëse dhe sistematike, që i merr parasysh elementet e lartpërmendura, do t'i shtonte mundësitë e trasimit të rrugës drejt një privatizimi të suksesshëm dhe një ringjalljeje ekonomike të Kosovës, e cila pastaj vërtetë do të mund të quhej një nga misionet faqebardha të paqeruajtjes së Kombeve Bashkuara bashkëkohore.

SHKURTESAT

DTI	Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë
BE	Bashkimi Evropian
RFJ	Republika Federative e Jugosllavisë
IRJM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
SPAP	Strukturat e Përbashkëta të Administratës së Përkohshme
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
IPV	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
NP	Ndërmarrjet publike
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
NSH	Ndërmarrjet shoqërore
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
OKB	Kombet e Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara
KS i OKB	Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

Shënime

¹ Rregullorja Nr.1999/1 e UNMIK-ut, e datës 25 korrik 1999, mbi Autoritetet e Administratës së Përkohshme në Kosovë, me ndryshimet nga Rregullorja Nr.2000/24 e UNMIK-ut, pjesa 4.

² Rregullorja Nr.1999/24, e datës 12 dhjetor 1999, mbi Ligjet e Zbatueshme në Kosovë, me ndryshimet nga Rregullorja Nr.2000/59 e UNMIK-ut, pjesa 1.1.

³ po aty, paragrafi 1.2.

⁴ po aty, paragrafi 1.1

⁵ “Ndërtimi i një strategjie afatmesme të zhvillimit ekonomik të Kosovës “ (2003-2005), më 17 shtator 2002, f.12. Nëse nuk thuhet ndryshe, paraqitja e informatave dhe të të dhënave nga situata aktuale ekonomike janë të marra nga ky raport.

⁶ Po aty, f.13.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty, f.15.

¹⁰ “*Njësitë për mësimet e marra dhe analiza e shtyllës së BE-së të UNMIK-ut në Kosovë (MNA)*”: Dilema Otomane - marrëdhëniet pushtetare dhe pronësore nën Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Prishtinë: 2002, f.8; “*Njësitë për mësimet e marra dhe analiza e shtyllës së BE-së/Projekt për Kosovën nga ESI (MNA)*”: Çindustrializimi dhe kolapsi i pronës shoqërore – Studimi i rastit të Pejës, Prishtina/Berlin:2002.

¹¹ E.Hobsbaëm: “Epoka e ekstremeve” – Shekulli i shkurtër XX, 1914-19991, Londër: 1994, faqe 78-115.

¹² Gazeta Zyrtare e Federatës Demokratike të Jugosllavisë 2/1945; Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë 63/46, 105/46.

¹³ Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale e Jugosllavisë 64/1945.

¹⁴ *Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Shtylla IV (BE)*: Memorandum informativ nga Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse dhe nga Zyra e këshilltarëve ligjorë mbi Rregulloren e propozuar për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, në mars të vitit 2002.

¹⁵ V.Misajlovski: Mbi shfrytëzimin e objekteve që i përkasin pronës shoqërore, në “Zakonitost”, Zagreb, 1958, f. 438; shih edhe Ligjin për Ndërtim të Kosovës, neni 38 dhe 39, (Gazeta Zyrtare e Kosovës 44/76)

¹⁶ Misajlovski, f. 446.

¹⁷ Ligji Federal mbi Kompanitë, nenet 75-79, (Gazeta Zyrtare e RFJ-së 77/88).

¹⁸ Ligji Federal mbi Rregullimin, Falimentimin dhe Likuidimin të Detyrueshëm, neni 135, (Gazeta Zyrtare e RFJ-së, 84/89).

¹⁹ LLA: Dilema otomane, f. 11.

²⁰ Po aty, f.13.

²¹ T. O’Neill: “Komericalizimi i ndërmarrjeve shoqërore d.m.th. punë dhe investime”, në “Fokus Kosova”, tetor 2001.

²² Kompanitë në fjalë janë: “Sharri Cement”, “Mirusha”, Mishtorja “Progresi”, “Progres-Eksport”, “Fapol”, “Mustafa Goga”, “Alcon Luledielli”, “Betonjerka”, “Adi

Shpesëtaria”, Fabrika e Tullave “Kosova”, “Termovent”, “Minex”.

²³ LLA: Dilema otomane, f.20.

²⁴ Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9, 15 maj 2001, për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, Kaptina 8.1 (q) dhe (r).

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty.

²⁷ Mendimi ligjor i Zyrës për Punë Juridike të Kombeve të Bashkuara, e datës 1 shkurt 2002, në Drafttregullorën mbi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (pa dokument), pika 6.

²⁸ Po aty.

²⁹ Rregullorja e UNMIK-ut, Nr.2002/12, paragrafi 2.1, 2.2 (a) dhe 5.1.

³⁰ Paragrafi 3.

³¹ Neni 3.

³² Paragrafi 6.1.

³³ Lista e plotë e kompetencave gjendet në paragrafët 6.1 (a) deri (s).

³⁴ Neni 7.

³⁵ Paragrafi 8.1.

³⁶ Paragrafi 8.4.

³⁷ Neni 9.

³⁸ A.Shala: Privatizimi – sfida kryesore, në “Fokus Kosova”, qershor 2002; A.Wittkowsky: NSH! Është koha për privatizim, në “Fokus Kosova”, prill 2002.

³⁹ Paragrafi 11.1.

⁴⁰ Paragrafi 15.1.

⁴¹ Paragrafi 12.1.

⁴² Paragrafi 12.2.

⁴³ Paragrafi 12.3.

⁴⁴ Paragrafi 14.3.

⁴⁵ Paragrafi 14.6.

⁴⁶ Paragrafi 14.7.

⁴⁷ Paragrafi 16.3.

⁴⁸ Paragrafi 16.1.

⁴⁹ Paragrafi 16.2.

⁵⁰ Korniza Kushtetuese, paragrafi 11.1.

⁵¹ Mbi shpronësimin nën të Drejtën Ndërkombëtare Publike, shih P.Malanczuk: Hyrje bashkëkohore në të Drejtën ndërkombëtare, Londër/New York: 1997, f.235.

⁵² I.Brownlie: Parimet e së Drejtës ndërkombëtare publike, Oxford:1998, p.686.

⁵³ Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2002/13, paragrafi 4.1. Paragrafët në vijim, nëse nuk thuhet ndryshe, janë ato nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13.

⁵⁴ Paragrafi 4.1.

⁵⁵ Paragrafi 4.2

⁵⁶ Paragrafi 4.2

⁵⁷ Paragrafi 4.3.

⁵⁸Paragrafi 3.1.

⁵⁹Paragrafi 3.1.

⁶⁰Paragrafi 3.2.

⁶¹Paragrafi 9.2.

⁶²Paragrafi 5.5. (b)

⁶³Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2000/45, paragrafi 44.1.

⁶⁴Parathënie nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2000/45, që i referohet Kartës Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale.

⁶⁵Rregullat mbi parimet e Dhomës së Veçantë, aktualisht janë vetëm në formë të projektit, por pritet të nxirren në formë të urdhrimit administrativ nga PSSP-ja.

⁶⁶Rezoluta 1244 (1999) e KS të OKB-së nuk paragjykon statusin përfundimtar të Kosovës, duke përfunduar se mundësia për një Kosovë të pavarur nuk mund të përjashtohet.

⁶⁷Drafttregullorja e UNMIK-ut mbi të Drejtën për Shfrytëzim të Pronave të Paluejtshme Shoqërore , 8 tetor 2002, paragrafi 2.1. Paragrafët në vijim, më në hollësi, janë në Drafttregulloren e UNMIK-ut mbi të Drejtën për Shfrytëzim të Pronave të Paluejtshme Shoqërore.

⁶⁸Paragrafi 3.1.

⁶⁹Paragrafi 3.2.

⁷⁰Paragrafi 3.1.

⁷¹Paragrafi 1.

⁷²Paragrafi 1.

⁷³Intervistë me kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

⁷⁴Projektligjet mbi të drejtën pronësore dhe mbi hipotekat për momentin janë duke u përpunuar nga Kuvendi i Kosovës , megjithëse nuk është e paqartë nëse këto projekte vërtet pasqyrojnë rregulloren e përsosur dhe të saktë mbi çështjen në fjalë. Një analizë e këtyre çështjeve, megjithatë, do t'i tejkalojë synimet e këtij studimi.

⁷⁵Shembulli më i mire do të jetë Rregullorja e UNMIK-ut Nr.1999/3 mbi Ndalimin e lojrave të fatit.

design & prepress: PIKA (www.pikastudio.net)

Katalogimi në publikim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

338.246.025.88 (496.51) (06)

MISIONI i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe privati-zimi i pronës shoqërore : Përshkrim kritik i procesit aktual të privatizimit në Kosovë / [Përpiluar nga Robert Muharremi]. - [Ribotim]. - Prishtinë : KIPRED, 2005 (Prishtinë : „ADD"). - VI, 28 fq.; 24 cm. - (Seria e kërkimeve politike : Studimi # 1)

Shkurtesat : fq.24. - Shënime : fq.25-27

1.MUHARREMI, Robert

ISBN 9951-14-012-2

Për KIPRED-in

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave ka për qëllim të përkrahë vlerat demokratike në Kosovë përmes trajnimeve dhe analizave të pavarura të politikave publike.

Trajnimet kryesisht fokusohen në zhvillimin e partive politike përmes Internet Akademisë për Demokraci, e zhvilluar në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare Olof Palme nga Suedia.

Kërkimet fokusohen në botimin e analizave të pavarura në fusha si qeverisja e mirë, administrata, zhvillimi i partive politike, bashkëpunimi rajonal, politika ekonomike dhe qeverisja lokale.

KIPRED-i financohet nga fondacioni suedez “Olof Palme International Center” dhe nga fondacioni amerikan “Rockefeller Brother’s Fund”.

KIPRED
Kodra e Diellit, Rr. III, Ll. 39
Prishtinë, Kosovë (UNMIK)
Tel/Fax: +381 (0) 38 555 887
Info: kipred@hotmail.com
www.kipredinstitute.org

Përkrahur nga:



Rockefeller
Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World